

V E N D I M
Nr.553, datë 2.12.1999

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I AUTOSTRADËS RROGOZHINË-LUSHNJË, TË
KORRIDORIT VERI-JUG**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 dhe 9 të ligjit nr.7848, datë 25.4.1994 “Për shpronësimin për interes publik, si dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive të paluajtshme”, me propozimin e Ministrisë së Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i autostradës Rrogozhinë-Lushnjë, të ndodhura në teritorin e rrethit dhe të Bashkisë Lushnjë, pronë e pronarëve të shënuar në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Transportit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas listave emërore, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për shumën e përgjithshme prej 64 636 856 (gjashtëdhjetëekatër milionë e gjashtëqindetridhjetëegjashtë mijë e tetëqindpesëdhjetëegjashtë) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga fondi i miratuar për këtë objekt në buxhetin e vitit 1999, për Ministrinë e Transportit, në zërin “Shpronësime”.

5. Shpronësimi të përfundojë brenda vitit 1999.

6. Ngarkohen Ministria e Transportit, Ministria e Pushtetit Lokal, Këshilli i Rrethit të Lushnjës, Bashkia Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta